



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

Nr. 279/1

dt. 15.02.2019

VENDIM (Qarkullues)

Nr. 5, datë 15/02/2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 12, DATË 30.10.2018 TË SENATIT AKADEMIK "PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2018 - 2019 DHE TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR", TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE" SI DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË PËR VITIN AKADEMIK 2018 - 2019" NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 3, gërma ç, neni 38, VKM Nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", ndryshuar me VKM Nr. 723, datë 06.12.2018, si dhe me VKM Nr. 778, datë 26.12.2018, Vendimin Nr. 9, datë 02.02.2009 të Senatit Akademik "Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Senatit Akademik", Senati Akademik,

VENDOSI:


1. Në vendimin nr. 12, datë 30.10.2018 të Senatit Akademik bëhen disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1 Studentët që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2018 - 2019 dhe në vijim, paguajnë tarifën e shkollimit në masën 50% të

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

vlerave të pasqyruara në pikën 1 (tabela nr. 2) të vendimit nr. 12, datë 30.10.2018 të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 778, datë 26.12.2018 "Për një ndryshim dhe shtesë në VKM Nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë".

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:


"Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i ciklit të parë ose studenti i regjistruar në një program të integruar të studimeve në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit si përsëritës i vitit akademik, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet. Tarifa vjetore e shkollimit, paguhet nga studenti përsëritës në masën 50% të vlerave të pasqyruara në pikën 1 (tabela nr. 2) të vendimit nr. 12, datë 30.10.2018 të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të VKM Nr.778, datë 26.12.2018 "Për një ndryshim dhe shtesë në VKM Nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë".

c) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

"2/1 Studenti i regjistruar në një program studimi të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij (3 vjet cikli parë dhe 5 vjet studimet e integruara), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2018 – 2019".

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upi.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

"2/2 Studenti i regjistruar në një program studimi të ciklit të dytë i cili brenda kohëzgjatjes normale të studimit (Master profesional ose Master i shkencave) nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit, do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2018-2019".

ç) Pika 3 e Vendimit të Senatit Akademik Nr. 12, datë 30.10.2018, shfuqizohet.

d) Pika 7 e Vendimit të Senatit Akademik Nr. 12, datë 30.10.2018, shfuqizohet.

dh) Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

"Përfundimisht, për vitin akademik 2018 – 2019, pagesa e tarifës të shkollimit mund të bëhet deri para fillimit të semestrit të dytë. Pagesa e tarifës të shkollimit për ciklin e dytë të studimeve mund të bëhet e ndarë në këste. Kësti i parë mund të paguhet para fillimit të semestrit të dytë dhe kësti i dytë para fillimit të sezonit të provimeve të verës. Studentet nuk do të ndalohen të hynë në provimet e sezonit të dimrit të vitit akademik 2018-2019, për arsye të mospagesës të tarifës së shkollimit".

2. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin nr. 12, datë 30.10.2018 të Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

SENATI AKADEMIK

KRYETAR

Prof. Dr. Andrea MALIQARI



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë

Tel/Fax: +355 4 2227914,

web: www.upt.al